



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:267311

Datë: 27.11.2019

Numri i dokumentit: 00679682

A.nr.1017/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Rexhep Gashi dhe me procesmbajtësen Gylten Dubovci, në konfliktin administrativ të paditësit A. A. nga Gj., kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e Aktvendimit nr.01.3.2.2/294 i datës 18.05.2017, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit avokat M.A. dhe përfaqësueses së autorizuar të paditurës B. G., me datë 16.10.2019, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** kërkesëpadia e paditësit A.A. nga Gj., si e bazuar.
- II. **ANULOHET** Aktvendimi me nr.01.3.2.2/294 i datës 18.05.2017, i Doganës së Kosovës në Prishtinë dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.
- III. Shpenzimet e procedurës i bart secila palë.

A r s y e t i m

Me vendimin kontestues, e paditura Dogana e Kosovës ka refuzuar si të pabazuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimit me nr.R2514 të datës 07.04.2017 të Zyrës Doganore Dheu i Bardhë-Terminal.

Paditësi, me padinë e paraqitur në gjykatë, me datë 19.06.2017, ka iniciuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës, siç kuptohet nga padia për shkak se nuk janë aplikuar drejtë dispozitat ligjore dhe për shkak se nuk është vërtetuar drejtë gjendja faktike, përmes të cilës ka kërkuar aprovimin e kërkesëpadisë si të bazuar, anulimin e aktvendimit të sektorit për rishqyrtimin e vendimit dhe të detyrohet e paditura që paditësit t'ia pranoj çmimin e blerje së veturës në vlerë prej 8,613.45€.

Tutje, paditësi në padi dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor ka deklaruar se fillimisht e precizon bazën juridike të dhënë në padi nga pasurimi i pa bazë në anulimin e vendimit të paditurës mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim. Ka theksuar sembetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë të paditësit dhe provave të bashkangjitura në padi. E kundërshton në tërësi si të pabazuar përgjigjen e të paditurës sepse konsideron se e njëjta nuk ka mbështetje në prova ngase për derisa në aktvendimin e të paditurës mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtimin e vendimit nr.E.2514 të datës 07.04.2017 e që mbanë numrin 01.3.2.2/94 prej datës 18.05.2017, nga e paditura thuhet se nga paditësi nuk është paraqitur transaksioni bankar, kontrata e shitblerjes që do të dëshmonte vlerën reale të automjetit. Paditësi me prova relevante të cilat gjenden në shkresat e lëndës e argumenton se automjeti i doganuar i paditësit ishte blerë

për shumën e parave prej 10,250.00€ ndërsa prej kësaj shume paditësit i ishte kthyer shuma 1.636.55€. Përveç avansit në shumë prej 750.00€ që kishte paguar me para të gatshme shumë tjetër e ka paguar nëpërmes xhiro llogarisë bankare e çka në shkresat e lëndës ekziston prova materiale. E paditura pa bazë ligjore nuk i merr për bazë këto prova por automjetin e paditësit e vlerëson në bazë të katalogut nr.10/2016 në shumë prej 11.053,00€.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditësit i propozoj gjykatës që pas vlerësimit të këtyre provave një nga një dhe të gjitha së bashku dhe në bazë të rezultatit të nxjerr nga besimi i këtyre provave, ta aprovoj si të bazuar në ligj kërkesën e paditësit, me ç'rast ta anuloj aktvendimin e kontestuar si të pabazuar në ligj në këtë çështje administrative.

E paditura përmes përfaqësueses ligjore Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore, në përgjigjen në padi të datës 12.07.2019 ka deklaruar se konteston në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Ka shtuar se vendimi i atakuar është i bazuar në të gjitha dispozitat në fuqi, ndërsa pala paditëse pretendimet e veta nuk i ka arsyetuar as edhe me një provë.

I autorizuari i të paditurës në seancën e shqyrtimit kryesor ka theksuar se sektori i pranimit qendror ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim, nuk është vlera reale e paguar të mallit me qëllim të importit në vendin tonë, për arsye se është deklaruar vlerë më e vogël se sa vlera reale e paguar, apo që ka për tu paguar për mallin e shitur për eksport përkatësisht për import në vendin tonë konform nenit 33 të KDA-së. Gjithashtu subjekti nuk ka paraqitur transaksionin bankar, kontratën e shitblerjes, që do të dëshmonte vlerën reale që ka paguar blerësi për shitje. Nuk qëndron pretendimi i subjektit se në shkallën e dytë përbrenda Doganës ka paraqitur dokumente siç pretendon, sepse në shkresat e lëndës askund nuk ka prezantuar ato dokumente për të cilat i thekson.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës në fjalën përfundimtare ka deklaruar se bazuar në thëniet e lartcekura, e paditura i propozon gjykatës që të refuzohet në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit dhe ta lë në fuqi vendimin kontestues si të ligjshëm.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 16.10.2019, ka administruar provat dhe atë: Aktvendimin nr. 01.3.2.2/294 datës 18.05.2017 të Doganës së Kosovës, ankesën e paditësit të dorëzuar në Doganë të datës 05.05.2017, Deklaratën Doganore R-2514 e dt.07.04.2017, dokumentin e regjistrimit të automjetit, faturën me nr. 30000341/0 datës 27.03.2017, Deklaratën Eksportuese të dt. 06.04.2017, dokumentin për kthimin e TVSH datës 19.04.2017, kontratën e shitblerjes të datës 25.03.2017, dokumenti mbi pagesën bankare të datës 28.03.2017.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81G të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, në seancën e mbajtur me datë 16.10.2019, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, deklarimeve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata nga DUD-i kontestues i Doganës së Kosovës, shkresat e lëndës, si dhe aktvendimi kontestues ka nxjerr konstatimin se paditësi ka deklaruar për zhdoganim mallin "*automjet për udhëtar i përdorur të markës Golf VII, 1.6, diesel, viti i prodhimit 2013*", përmes deklaratës R-..... të datës 07.04.2017, me ç'rast pas pranimit dhe vlerësimit të DUD-it kontestuese, Dogana e Kosovës me arsyetimin se vlera e mallit për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar me qëllim importi në Kosovë, në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, ka rivlerësuar mallin lëndor të paditësit në bazë të metodës së gjashtë (6) të vlerësimit, përkatësisht në bazë të dhënave të disponueshme sipas katalogut me nr.10/2016 dhe në këtë

mënyrë e ka obliguar paditësin që të paguaj taksë doganore me të lartë se të deklaruar me faturën e mallit.

Gjykata nga aktvendimi kontestues vëren se ai përmban të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar. Të metat e tilla konsistojnë në faktin se arsyetimi i vendimit kontestues përmban të dhëna të pamjaftueshme dhe jo të plota sa i përket rivlerësimit të mallit lëndor, si dhe aktvendimi kontestues nuk përmban një vlerësim të fakteve në raport me dispozitat ligjore. Gjykata vlerëson se e paditura në arsyetimin e vendimit kontestues nuk ka dhënë arsyetim të bazuar se përse paditësit nuk i është pranuar deklarimi i mallit sipas faturës dhe dokumentit për kthimin e TVSH-së të datës 19.04.2017, në bazë të metodës së parë të vlerësimit, kur paditësi ka prezantuar dokumentacionin valid që dëshmon për çmimin e paguar për mallin e importuar.

Arsyetimi i të paditurës në vendimin kontestues se dokumentacioni përcjellës i mallit është vlerësuar si provë e pa mjaftueshme, pasi që paditësi nuk ka paraqitur transaksionin bankar dhe kontratën e shitblerjes për të dëshmuar vlerën reale të paguar, për gjykatën nuk është arsyetim i bazuar në dispozita ligjore, për arsye se dispozita ligjore e nenit 123 par.1 pika (a) e UA nr.11/2009 për Implementimin e Kodit Doganor dhe Akcizave nr.03/L-109 në mënyrë taksative ka paraparë dokumentet që duhet bashkëngjitur deklaratës doganore për vendosje në qarkullim të lirë të mallit, dhe aty thuhet *“fatura në bazë të së cilës deklarohet vlera doganore e mallrave, siç kërkohet sipas nenit 91 të këtij akti”*. Prandaj, gjykata vlerëson se e paditura nuk i ka vërtetuar në mënyrë të drejtë faktet të cilat i ka paraqitur paditësi, siç nga faktet e vërtetuar ka nxjerr konkluzion të gabuar të gjendjes faktike rrjedhimisht nuk ka aplikuar në mënyrë të drejtë as dispozitat ligjore të cilat i përcaktojnë dokumentet e kërkuara ligjërisht, për tu paraqitur me rastin e deklarimit të mallit për zhdoganim dhe vendosje në qarkullim të lirë.

Gjykata në këtë procedurë gjyqësore të konfliktit administrativ ka pranuar si provë të re të dorëzuar nga paditësi kontratën e shitblerjes të datës 25.03.2017 si dhe dokumentin mbi pagesën bankare të datës 28.03.2017, në bazë të nenit 81.H të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 e cila dispozite parasheh se *“Gjykata mund të lejoj prova të reja kur :4.1. provat nuk kanë qenë në dispozicion gjatë kohës së kundërshtimit të vendimit; 4.2. provat janë të nevojshme për të evituar shfaqjen e padrejtësive për palën e cila e kërkon shqyrtimin e tyre.*

Tutje, gjykata gjen se e paditura në këtë rast nuk ka kërkuar dokumente tjera shtesë, për të vërtetuar saktësinë e të dhënave nga deklarata doganore dhe nuk e ka njoftuar paditësin në formë të shkruar për dyshimin se vlera e deklaruar e mallit nuk është vlera reale e paguar, siç përcaktohet me dispozita të nenit 72 të KDA-së dhe nenit 92 të UA nr.11/2009, andaj gjykata vlerëson se provat e paraqitura nga paditësi në këtë konflikt janë të domosdoshme për të evituar shfaqjen e padrejtësive, të cilat kanë ndodhur me rastin e rivlerësimit të mallit të importuar.

Gjithashtu, gjykata konstaton se në procesverbalin mbi përcaktimin e vlerës së mallrave të datës 11.04.2017, i cili gjendet në shkresat e lëndës, mbi bazën e të cilit e paditura e ka bazuar rivlerësimin e mallit-automjetit për paditësin thuhet se lënda është vlerësuar sipas katalogut nr.10/2016, mirëpo një katalog i tillë nuk është paraqitur si provë nga e paditura në këtë konflikt administrativ, siç ka pasur obligim e paditura ta bëjë në vështrim të nenit 37.3 të LKA-së. Së këndejmi, gjykata e ka të pa qartë edhe bazën ligjore të këtij katalogu, i cili ka shërbyer si e dhënë e disponueshme, ku e paditura e ka bazuar rivlerësimin e mallit.

Gjykata konstaton se paditësi në këtë procedurë të konfliktit administrativ i ka paraqitur gjykatës faturën e mallit lëndor me nr.130000341/0 të datës 05.05.2017, dokumentit për kthimin e TVSH-së të datës 19.04.2017 në vlerë prej 1,636.55€, në emër të paditësit, ku paraqitet TVSH-ja prej 19% e cila i është kthyer paditësit sipas faturës së mallit, kontratën e shitblerjes të datës 25.03.2017, si dhe dokumentin e

pagesës së mallit të dt.28.03.2017. Të gjitha këto dokumente rezultojnë të jenë të harmonizuara në tërësi sa i përket vlerës së mallit të importuar.

Gjykata konsideron se aplikimi i metodës së gjashtë të vlerësimit (MV6), në vështrim të nenit 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave është veprim i cili bie ndesh me dispozitat e nenit 33-35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109, për arsye, se para se të aplikohet metoda e radhës e vlerësimit gjegjësisht metoda e 6 e vlerësimit, duhet të jepen arsyet dhe provat për ta kontestuar vlerën e mallit lëndor dhe dokumentacionin e dorëzuar me kërkesë nga paditësi si fatura e mallit, dokumentit për kthimin e TVSH-së të datës 19.04.2017 dhe dokumentet tjera përcjellëse të mallit.

Nga një gjendje e tillë e çështjes, gjykata e ka të pamundur të vendos në mënyrë meritore në këtë konflikt administrativ, për arsye se ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, ngase se arsyetimi i të paditurës se Zyra e Pranimit ka vepruar drejtë kur ka kontestuar vlerën e mallit lëndor, pasi që vlera e mallit e deklaruar për zhdoganim nuk është vlera reale e paguar për mallin me qëllim importi në vendin tonë, për gjykatën është i pa bazuar dhe nuk paraqet kurrfarë dëshmie të bazuar në ligj, mbi vlerën reale doganore të mallit të importuar nga paditësi.

Prandaj, me qëllim të konstatimit të drejt të çështjes, me prova materiale shtesë, lidhur me kontestin e vërtetësisë së dokumentacionit përcjellës të mallit lëndor, gjykatës i duhet sqarim plotësues, verifikim dhe sigurim i provave shtesë, në mënyrë që konstatimi i dhënë në arsyetim të aktvendimit të kontestuar të mbështetet në prova materiale. Në ri procedurë e paditura duhet të shqyrtoj dhe të deklarohet lidhur e provat e paraqitura nga paditësi përfshirë faturën e mallit lëndor me nr.130000341/0 të datës 05.05.2017, dokumentit për kthimin e TVSH-së të datës 19.04.2017, kontratën e shitblerjes të datës 25.03.2017, dhe dokumentin mbi pagesën bankare të datës 28.03.2017.

Gjykata kërkon nga e paditura Sektori i Rishqyrtimit të Vendimeve/Dogana e Kosovës që në ri procedurë para se të aplikoj të dhënat e disponueshme që disponon për mallin lëndor, të vlerësoj metodat paraprake të vlerësimit, të verifikoj vërtetësinë e dokumentacionit përcjellës të mallit në aspektin e harmonizimit të vlerës së mallit të deklaruar, ashtu që të shqyrtoj pretendimet e paditësit se ka prezantuar dokumentet e nevojshme që kërkohen me dispozitat e nenit 123 të Udhëzimit Administrativ nr.11/2009 mbi Implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109, pastaj të verifikohet vlera e paguar e faturës për mallin lëndor sipas dokumentit për kthimin e TVSH-së të datës 19.04.2017 dhe dokumentit të pagesës të datës 28.03.2017 dhe nëse ajo harmonizohet me vlerën e deklaruar, sipas faturës përcjellëse të mallit lëndor. Me rastin e nxjerrjes së vendimit të ri e paditura të vlerësoj drejt gjendjen faktike që rezulton nga dokumentacioni i mallit dhe të aplikoj drejt dispozitën ligjore me të cilën përcaktohet vlerësimi i mallrave.

Të metat e cekura më lartë janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, prandaj gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanojë të metat e cekura, të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj. Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë, gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 43 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2019:267311
Datë: 27.11.2019
Numri i dokumentit: 00679682

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal
A.nr.1017/17, datë 16.10.2019

Gj y q t a r i
Rexhep Gashi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.